EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5695
E mërkurë, 6 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Thaçi: Nuk do të jetë proces i lehtë arritja e marrëveshjes me Serbinë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

Institucionet e Republikës së Kosovës i reagojnë Bashkimit Evropian (BE) për 'Trepçën'

Haradinaj dhe Veseli thonë se 'Trepça' nuk do të jetë pjesë e dialogut në Bruksel

FAQE 8-9

Kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryeparlamentari Kadri Veseli kanë reaguar ndaj deklaratës së zëdhënëses së Komisionit Evropian, Maja Kocijançiq, se "Trepça" duhet të jetë pjesë e dialogut. Haradinaj dhe Veseli kanë theksuar se me këtë gjuhë BE-ja është duke e rrënuar çdo perspektivë të dialogut dhe fqinjësisë së mirë. Sipas tyre, "Trepça" nuk është çështje e hapur në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kryeministri dhe kryeparlamentari kanë thënë se sot e përgjithmonë "Trepça" është e drejtë natyrore e shtetit të Kosovës. Ndaj kësaj deklarate kanë reaguar edhe liderët e partive opozitare

Opozita insiston në zgjedhje, koalicioni synon ta çojë mandatin deri në fund

Sikurse për çështje të tjera, edhe për zgjedhje të parakohshme pozita dhe opozita vazhdojnë të kenë qëndrime diametralisht të kundërta. Përderisa opozita insiston që vendi të shkojë në zgjedhje, si zgjidhja e duhur, pozita synon ta çojë deri në fund mandatin qeverisës. Sipas përfaqësuesve të koalicionit qeveritar, aktualisht fokusi nuk duhet të jetë te zgjedhjet e reja, por te zgjidhja përfundimtare me Serbinë. Por, përfaqësuesit opozitarë kanë vlerësuar se subjektet politike kanë nevojë për legjitimim të ri për të qenë pjesë e vendimmarrjes së marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi FAQE 4

Invalidët dhe dëshmorët e UÇK-së kërkojnë rritjen e pensioneve

FAQE 2

AKTUALE

A DUHET TË VAZHDOJË DIALOGU NË BRUKSEL? F. 11

Jakup KRASNIQI

SHSKUK-ja DO TË PUNËSOJË 103 MJEKË SPECIALISTË TË PAPUNË F. 6

GRABITJE E ARMATOSUR NË NJË FILIALE BANKE NË ÇAGLLAVICË F. 11

EKONOMI

BASHKËPUNIMI ME BERZH-in DO TË NDIKOJË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS F. 8

OEAK-U: NGRITJA E VAZHDUESHME E PAGAVE NË SEKTORIN PUBLIK KËRCËNON STABILITETIN BUXHETOR F. 9

SPORT

GASHI: KOSOVA DO TË FITOJË MEDALJE NË LOJËRAT OLIMPIKE F. 16

DREJTUESIT E FFK-së SHKOJNË NË ROMË PËR KONGRESIN E UEFA-s F. 16

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ahmeti: Nga njohja reciproke Kosovë - Serbi përfiton i tërë rajoni

SHKUP, 5 SHKURT - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, gjatë një takimi me Rachel Galloway, ambasadore e Britanisë së Madhe në Maqedoninë e Veriut, biseduan për situatën politike në vend dhe rajon, ndërtimin e BDI-së për dy dekadat në vijim, si dhe për zgjedhjet presidenciale.

Ahmeti me këtë rast falënderoi Britaninë e Madhe për mbështetjen në të gjitha proceset progresive në vend drejt mbylljes së kontesteve me fqinjët, integrimit euroatlantik dhe reformave në vend. Ai ftoi edhe fondacionin britanik Westminster që të kyçet në ndërtimin e BDI-së për dy dekadat vijuese në aspekt strukturor dhe programor.

Në lidhje me zgjedhjet presidenciale, Ahmeti ka folur rreth konceptit të një kandidati të pranueshëm për bartësit e legjitimitetit politik të deleguar nga qytetarët dhe në përputhje me pritjet e tyre.

Ndërsa në lidhje me dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, kreu i BDI-së përsëriti nevojën e përmbylljes së demarkacionit dhe njohjes së ndërsjellë midis dy vendeve nga e cila do të përfitonte tërë rajoni.

Meta: Marrëveshja Kosovë - Serbi t'i ketë garantues ShBA-në dhe BE-në

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, tha në Senatin amerikan, se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të prodhojë paqe, stabilitet, siguri afatgjatë në rajon duke pasur ShBA-në dhe BE-në garantues

UASHINGTON, 5 SHKURT - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ishte i ftuar nderi në Senatin amerikan nga kryetari i Komisionit të Mbrojtjes, senatori Jim Inhofe, për të mbajtur fjalën në forumin me temë: "Sfidat e rajonit të Evropës Juglindore dhe përballja me ndërhyrjen nga Rusia". Meta ka theksuar se marrëveshja Kosovë - Serbi do të prodhojë paqe duke pasur ShBA-në dhe BE-në garantues. "Ne jemi të bindur se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të prodhojë paqe, stabilitet, siguri afatgjatë në rajon duke pasur ShBA-në dhe BE-në garantues", tha Meta.

Presidenti Meta tha se rezultatet e kësaj marrëveshjeje përfundimtare do të thonë se Kosova do të jetë njohur nga Serbia si një shtet i pavarur dhe anëtar me të drejta të plota i Kombeve të Bashkuara. "Ndryshimi i vetëm kufitar për të cilin duhet të punojmë natë e ditë në rajonin tonë është zgjerimi i plotë i kufirit evropian në Ballkanin Perëndimor", ka thënë Meta.

Presidenti Meta gjatë këtij fjalimi njoftoi audiencën me sfidat e sigurisë në rajonin e Evropës Juglindore dhe rolin e Shqipërisë në politikën rajonale, qëndrimin e tij mbi bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuara nga BE-ja, si dhe përpjekjet dhe reformat e vendit drejt integrimit në Bashkimin Evropian.

Presidenti Meta tha se Ballkani ka pësuar transformime të thella në dy dekadat e fundit në të cilat kanë investuar seriozisht ShBA-ja dhe BE-ja.

Një nga investimet më të mëdha dhe të suksesshme ka qenë Pavarësia e Kosovës dhe në vijimësi vendosja e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në dobi të normalizimit të marrëdhënieve dhe të stabilitetit, paqes dhe sigurisë afatgjatë në rajon.

Marrëveshja që mendohet të arrihet në mes të Kosovës dhe Serbisë është e rëndësishme të çlirojë energji pozitive, ta ndihmojë frymën e bashkëjetesës dhe të ndërtojë një të ardhme më të mirë për të dy vendet.

Lidhur me ndërhyrjen e Rusisë dhe rolin e saj në rajon, presidenti Meta u shpreh se e ardhmja e rajonit është Evropa e bashkuar dhe NATO-ja, ndërsa Shqipëria dhe shqiptarët do të vazhdojnë të jenë promotorë e integrimit të rajonit në NATO dhe BE.

Presidenti Meta foli edhe lidhur me situatën në Maqedoninë e Veriut dhe konsideroi miratimin nga dy parlamentet të ndryshimit të emrit si një arritje historike që do ta bëjë rajonin më të sigurt dhe do ta sjellë më pranë BE-së dhe NATO-s, duke theksuar se ky është një proces i rëndësishëm dhe jetik për të ardhmen e tij. Ai tha se zvogëlimi dhe mungesa e koordinimit të ShBA-së dhe Bashkimit Evropian si dhe përfshirjes së tyre në Ballkan mund të krijojë një vakum që do ta rriste praninë e Rusisë dhe aktorëve të tretë në rajon. "Suksesi i një paqeje të qëndrueshme në rajon ka ardhur si rezultat i partneritetit të fortë transatlantik, i cili mbetet jetik edhe sot, pavarësisht prej dallimeve. Destabilizimi i rajonit është në interes të Rusisë, ndërsa fati i tij në rajon është në BE dhe në NATO gjithashtu. Gjatë vizitës së tij në Beograd, presidenti Putin akuzoi ShBA-në dhe BE-në se po përpiqen ta destabilizojnë seriozisht rajonin", tha presidenti Meta para Senatit amerikan.

Basha: Është koha të ngrihemi si 500 vjet më parë!

TIRANË, 5 SHKURT - Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka qëndruar të martën në Krujë për organizimin e protestës së 16 shkurtit në Tiranë. "Bashkëbisedova me disa qytetarë dhe pronarë dyqanesh këtu në Krujë. Gjendja shumë e rëndë. Nuk pash një turist të trokasë në dyqanet e tyre. Klima është shumë e keqe. Ky është vendi për të dhënë një mesazh. 500 vjet më parë një vend i vogël i qëndroi fuqisë më të madhe ushtarake në botë. Pse? Sepse ishin të bashkuar, sot ka ardhur koha të çohemi sepse ne kemi kauzën e drejtë. Ne do ta kthejmë Shqipërinë në binarët evropianë. Ka ardhur koha të merrni në dorë fatin tuaj. Kjo është thirrja, kjo është ftesa", tha Basha nga Kruja.

Lulzim Basha ka shkuar derë më derë e ka bashkëbiseduar edhe me banorët e Fushë-Krujës. Duke i prezantuar planin ekonomik të PD-së i pari i demokratëve premtoi vende të reja pune, çlirim të ekonomisë dhe zhdukje të krimit. "Këto ditë kam nisur një tur për të takuar qytetarë, fermerë, të rinj, përfaqësues të biznesit të vogël, por po e shikoni që është e pamundur të bëhet tur bashkëbisedimi se në pak minuta e shihni si mbushen sheshet me njerëz që kanë shpresë se po vjen një shpresë e re. Kam ardhur sot që t'ju them se mezi po pres që me ndihmën tuaj, me bashkimin e gjithë shqiptarëve të flasim për vende të reja pune, për uljen e çmimit të naftës, për mundësi dhe për mirëqenie, për familje që e marrin ndihmën ekonomike. Të jeni të bindur që kjo ditë po vjen. Kjo ditë do vijë sa më shpejt të rrëzojmë këtë qeveri kriminale dhe këtë kryeministër hajdut", tha Basha.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Haradinaj: Serbia po e shantazhon procesin e dialogut

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se kushtëzimi i vazhdimit të dialogut me heqjen e taksës është shantazh që Serbia po i bën këtij procesi. Ai ka deklaruar se ndërkombëtarët nuk duhet ta lejojnë asnjërën palë që ta kushtëzojë këtë proces. Sipas kreut të ekzekutivit, me këtë veprim Serbia po tregon se nuk është e interesuar për dialog me Kosovën

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar të martën se Serbia po e shantazhon procesin e dialogut me Kosovën, kur po e kushtëzon atë me heqjen e taksës për mallrat serbe. Në një konferencë për medie, pas mbledhjes së Qeverisë, ai ka thënë se është gabim nëse njërës palë në proces i pranohet shantazhi. "Mendojmë se keqja e kësaj është pranimi i shantazheve të Serbisë, e cila po bën shantazh. Ky është shantazh i pastër. Edhe ne mund të deklarohemi se nuk vijmë në dialog pa u pranuar në Interpol, por ku shkojmë kështu", ka thënë Haradinaj.

Ai ka vlerësuar se nga kushtëzimi i këtij dialogu nuk humb vetëm Kosova. Sipas tij, Kosova është e interesuar që t'i kthehet dialogut për normalizimin e raporteve ndërmjet dy shteteve. "Vendosja e taksës është një vendim i Kosovës. Argumentet i kemi treguar. Kushtëzimi i dialogut është i papranueshëm. Nëse e bëjmë një listë të kushtëzimeve atëherë do të kishim kërkuar nga Serbia kërkimfalje për krimet që i ka bërë në Kosovë, pastaj kishim kërkuar kthimin e të pagjeturve, e kështu me radhë. Është e papranueshme të kushtëzohet dialogu. Ky proces duhet të rikthehet. Mendoj se nuk humb vetëm Kosova nëse nuk ndodh dialogu, por humb rajoni dhe më gjerë. Taksa do të mbetet deri në njohje. Besoj për këtë nuk keni dilema më", është shprehur Haradinaj.

I pari i Qeverisë ka thënë se në këtë pikë kanë qëllime të njëjta me ShBA-në. "Ne besojmë se qëllimi i Amerikës është edhe i yni. Ne kërkojmë kthimin e dialogut. Ne nuk e kuptojmë kushtëzimin, sepse Kosova nuk e ka kushtëzuar asnjëherë dialogun, edhe kur na janë hequr njohjet, edhe kur nuk jemi anëtarësuar në Interpol. Mendoj se Beogradi nuk po do dialog në këtë rast. Këtu nuk ka lidhje taksa. Pra, Beogradi nuk po do dialog dhe po vendos kushte", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke përsëritur se të njëjtën gjë mund ta bëjë edhe Kosova.

Haradinaj ka mohuar mundësinë e destabilizimit të situatës në veri të vendit nga deklarimet e kryetarëve të dy komunave të Mitrovicës. Sipas tij, situatën në vend mund ta destabilizojë vetëm lëvizja e kufijve. "Të vetmin rrezik që e shoh për destabilizim janë planet për tregti me kufij dhe territore", është shprehur Haradinaj.

Qeveria i jep statusin investitorit të parë strategjik, investim prej 170 milionë eurosh

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka aprovuar rekomandimin e Komisionit Ndërministror për Investime Strategjike për dhënien e statusit të investitorit strategjik për subjektin investues "Sowi Kosovo L.L.C. Vlera e kapitalit të këtij investimi strategjik është 169,093,575.00 euro.

Po në këtë mbledhje kabineti qeveritar është informuar për statusin e hartimit të Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Sipas kësaj informate, Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës është pjesë e programit legjislativ për vitin 2019. Me këtë projektligj përcaktohen parimet e punës së Qeverisë e cila, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ushtron pushtetin ekzekutiv, bazuar në parimin e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, transparencës, si dhe parimin e efikasitetit dhe efektshmërisë. Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës, përcakton përbërjen, mandatin e Qeverisë, fillimin dhe përfundimin e mandatit të anëtarëve të Qeverisë, si dhe kufizimet në kompetencat e Qeverisë në dorëheqje. Po me këtë projektligj përcaktohet statusi i anëtarëve të Qeverisë si dhe aktet me të cilat vendos Qeveria. Në këtë mbledhje, Qeveria ka marrë vendim që të ndajë mjete për mbulimin e shpenzimeve për shërim jashtë vendit të Arite Sylejmanit në vlerë prej 50 mijë eurosh.

Veseli: Do t'i qëndroj deri në fund koalicionit me Haradinajn

PRISHTINË, 5 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se koalicionit me kryeministrin Ramush Haradinaj do t'i qëndrojë deri në fund. "Unë Ramush Haradinajt ia kam dhënë përkrahjen, e kam bërë kryeministër të Kosovës. Edhe do t'i qëndroj deri në fund. Në jetën time vetëm etika dhe korrektësia më mban", ka thënë Veseli në një intervistë për "Info Magazine" në "Klan Kosova"

Veseli ka thënë se ky koalicion qeverisës është duke bërë punë. "Ky kryeministër është duke bërë punë. Jemi duke marrë vendime bashkërisht. Imagjinojeni vetëm rritjen e pagave që e kemi bërë në situatën kur shumica e vendeve përreth janë në krizë ekonomike", ka thënë Veseli. Ai ka thënë se ka një gajle: sinqeritetin dhe patriotizmin real të Ramush Haradinajt. "Disa rrenacakë e përdorin sinqeritetin e tij për të dalë ai kundër partneritetit perëndimor, ShBA-së dhe BE-së", ka thënë Veseli.

Opozita insiston në zgjedhje, koalicioni synon ta çojë deri në fund mandatin

Sikurse për çështje të tjera, edhe për zgjedhje të parakohshme pozita dhe opozita vazhdojnë të kenë qëndrime diametralisht të kundërta. Përderisa opozita insiston që vendi të shkojë në zgjedhje si zgjidhja e duhur, pozita synon ta çojë deri në fund mandatin qeverisës. Sipas përfaqësuesve të koalicionit qeveritar, aktualisht fokusi nuk duhet të jetë te zgjedhjet e reja, por te zgjidhja përfundimtare me Serbinë. Por, përfaqësuesit opozitarë kanë vlerësuar se subjektet politike kanë nevojë për legjitimim të ri për të qenë pjesë e vendimmarrjes së marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

Prishtinë, 5 shkurt - Ndonëse Kosova është duke u ballafaquar me dialogun me Serbinë dhe zgjidhjen përfundimtare në mes të dy vendeve, partitë opozitare insistojnë të shkohet në zgjedhje të reja. Dy partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV), mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme e shohin si zgjidhje të vetme për të ardhmen e vendit. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka thënë se, pavarësisht prej proceseve, vendi ka nevojë për zgjedhje të reja. Sipas tij, në këto zgjedhje do të ndodhte një legjitimim i ri i subjekteve politike të cilat pastaj do të duhej të marrin vendime në lidhje me marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. "Vetëvendosje mendon se zgjidhja është shkuarja në zgjedhje të reja, ku do të ndodhte një legjitimim i ri i subjekteve që i fitojnë ato zgjedhje, pastaj të cilat do të duhej të marrin vendime në lidhje me marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Natyrisht se ato bisedime duhet t'i zhvillojë qeveria e re, e cila del pas zgjedhjeve, e jo presidenti i vendit", ka deklaruar Kurteshi për gazetën "Epoka e re".

Edhe shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se zgjedhjet e reja janë të domosdoshme. "Koalicioni PAN duhet të ndalet. Nuk ka orientim shtetndërtues, por ka unitet vetëm për të mbetur në pushtet. Ky koalicion po rrezikon çdo gjë që kemi arritur deri më sot. Ky koalicion po e kthen perceptimin e Kosovës si vend me korrupsion në rritje. Zgjedhjet janë të domosdoshme për të ndalur këtë dëm që po i bëhet shtetit të Kosovës", ka deklaruar Hoti.

Në favor të zgjedhjeve të reja është shprehur e kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila. Ajo ka thënë për gazetën "Epoka e re" se zgjidhje për situatën e krijuar në Kosovë dhe për kaosin institucional janë zgjedhjet e jashtëzakonshme për kohën e organizimit të të cilave duhen marrë vesh partitë mes vete. "Absolutisht se zgjidhje për situatën e krijuar në Kosovë dhe për kaosin institucional janë zgjedhjet e jashtëzakonshme, për kohën e organizimit të të cilave duhen marrë vesh partitë mes vete. Qëndrimi ynë dallon me ata sepse ne mendojmë se duhet të ketë një qëndrim mes partive politike. Qeverisja Haradinaj nuk e ka potencialin dhe mundësinë që të bëjë zhvillime pozitive për Kosovën, prandaj vetëm po e degradon shtetin", ka deklaruar Kusari-Lila.

Madje lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, përveç se ka kërkuar që këtë vit të mbahen zgjedhjet e reja, sipas tij, Vetëvendosje do të jetë fituese e tyre. "Po. Zgjedhjet e ardhshme duhet të jenë këtë vit. Kam qenë i nominuar nga Këshilli i Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje për kryeministër. Kam fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet e 11 qershorit 2017. Arsyeja pse nuk ka zgjedhje, dihet fituesi - Lëvizja Vetëvendosje", ka thënë Kurti në emisionin "A Show" në News 24.

Por kërkesën e opozitës për zgjedhje të reja, përfaqësuesit e partive në pushtet po e konsiderojnë të panevojshme.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka thënë se partitë opozitare nuk duhet të bëjnë fushata populiste dhe kërkesa për zgjedhje të reja por, sipas tij, pozitë dhe opozitë duhet të fokusohen në momentumin për zgjidhjen përfundimtare me Serbinë. Ai ka theksuar se duhet të jesh shumë komod dhe i papërgjegjshëm që të mendosh për kauza personale e partiake në kohën kur para nesh janë interesat shtetërore dhe kombëtare. "Opozita po bën fushatë populiste për zgjedhjet e ardhshme me një kauzë e cila, më shumë sesa interes i partive politike, është interes i qytetarëve të vendit. Nuk do të duhej që me kauza të tilla të shërbehen qëllimet ditore politike. Edhe nga pozita mund të ketë qëndrime populiste, por opozita është aktualisht në agjendën partiake paraelektorale. Duhet të jesh shumë komod dhe i papërgjegjshëm që të mendosh për kauza personale e partiake në kohën kur para nesh janë interesat shtetërore dhe kombëtare. Nëse na është thënë nga aleatët tanë se kemi një mundësi historike që të përmbyllet ky proces me Serbinë atëherë do të ishte papërgjegjësi e plotë sikur këtë gatishmëri ta devijojmë në agjenda partiake e zgjedhore. Madje kjo do të sillte një situatë kur nuk do të mund ta parashikojmë se kur do të vijë një momentum tjetër i përshtatshëm. Pozita e opozita duhet të fokusohen në agjendën që është e mbështetur nga partnerët tanë", ka deklaruar Pajaziti për gazetën "Epoka e re".

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka thënë koalicioni qeverisës duhet ta çojë deri në fund mandatin për shkak të vendimeve të rëndësishme që është duke i marrë për vendin. "Normalisht se një qeveri çfarë është kjo tani, e cila po merr vendime të mëdha për vendin, meriton ta kryejë mandatin, madje ta garantojë edhe mandatin e ardhshëm qeverisës", ka theksuar Isufi për gazetën "Epoka e re".

Thaçi: Nuk do të jetë proces i lehtë arritja e marrëveshjes me Serbinë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se mbështetja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është vitale për Kosovën. Ai ka theksuar se nuk do të jetë proces i lehtë arritja e marrëveshjes me Serbinë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

UASHINGTON, 5 SHKURT - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka zhvilluar një bashkëbisedim në "Council on Foreign Relations" në Uashington DC, ku para një audience të specialistëve të rajonit ka folur për përpjekjet për arritjen e një marrëveshjeje të paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Marrëveshja gjithëpërfshirëse e paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë do të sjellë paqe në Kosovë, paqe dhe stabilitet në rajon dhe do të ketë rol transformues në shoqërinë tonë", u shpreh presidenti Thaçi, duke shtuar se nuk do të jetë proces i lehtë arritja e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë por, sipas tij, është e vetmja rrugë përpara për ta evituar kthimin prapa në tensione dhe konflikte.

Kreu i shtetit ka theksuar se qëllim kryesor i marrëveshjes është njohja e Kosovës nga Serbia dhe anëtarësimi i Kosovës në Kombet e Bashkuara. Duke shpjeguar pse rrethanat janë të favorshme për një marrëveshje gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë, presidenti Thaçi u shpreh se këtë herë duket se edhe Serbia është e interesuar për marrëveshje me Kosovën, ndërsa edhe Rusia duket e gatshme të pranojë një marrëveshje që do të arrihej në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Ndërkaq, duke folur për rolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, presidenti Thaçi u shpreh se mbështetja e Uashingtonit është vitale për Kosovën. "Sa herë Kosova ka qenë bashkë me Shtetet e Bashkuara ka dalë fitimtare. Edhe nëse kompromiset e bëra janë dukur të rënda në fillim, më vonë është treguar se kanë qenë vendimet më të mira strategjike", u shpreh presidenti Thaçi. Ai ka thënë se mbështetja e Shteteve të Bashkuara për marrëveshjen paqësore në mes të Kosovës dhe Serbisë është vitale për Kosovën. "Nuk do të pranojmë një marrëveshje që nuk është e pranueshme edhe për Uashingtonin", ka thënë ai.

Në këtë bashkëbisedim, presidenti Thaçi ka pranuar pyetje edhe nga audienca. James Pardew, diplomat amerikan dhe një nga përfaqësuesit e ShBA-së për Kosovën në vitet 1999-2001, e pyeti për çështjen e korrigjimit të kufirit. Në përgjigjen e tij, presidenti Thaçi u shpreh se një nga pikat e marrëveshjes gjithëpërfshirëse për paqe në mes të Kosovës dhe Serbisë sigurisht do të jetë edhe përcaktimi i kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Një nga pikat do të jetë edhe demarkimi i kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë", u shpreh presidenti Thaçi, duke shtuar se kjo është mundësi për ta korrigjuar kufirin edhe në veri të Kosovës, edhe në jug të Serbisë. "Nëse një korrigjim i lehtë i kufirit është çmimi për marrëveshje përfundimtare të paqes, atëherë kjo do të duhet të jetë e pranueshme. Por, pikat strategjike si Liqeni i Ujmanit, qyteti i tërë i Mitrovicës, 'Trepça', këto janë resurse të panegociueshme", ka pohuar presidenti Thaçi.

Pjesëmarrësit e tjerë kanë pyetur edhe për zhvillimin ekonomik dhe për reformat në Kosovë, për të cilat presidenti Thaçi theksoi se janë storie të suksesshme, por se vazhdimi i suksesshëm i tyre varet nga krijimi i stabilitetit politik. "Prandaj na nevojitet marrëveshja e përhershme e paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kjo do t'u hapë rrugë reformave, zhvillimit dhe transformimit pozitiv të tërë shoqërisë", përfundoi presidenti Thaçi.

Gashi takon Hoxhiqin, bisedojnë për gjendjen në veri

MITROVICË, 5 SHKURT (ER) - Kryetari i Partisë Liberale të Kosovës (PLK), Skënder Gashi, është takuar me ish-shefen e Zyrës Administrative në veri, Adrijana Hoxhiq, me të cilën ka biseduar për gjendjen në veri të Kosovës dhe për krijimin e urave të bashkëpunimit në mes të komuniteteve që jetojnë në atë pjesë. "Pas shumë vizitave dhe hulumtimeve që po i bëj në pjesën veriore të Kosovës, në komunat Leposaviq, Zveqan, Zubin Potok dhe Komunën e Mitrovicës së Veriut, takova Adrijana Hoxhiqin, zyrtare kryesore ekzekutive e komunës së veriut në Republikën e Kosovës. Kjo zonjë me dekada punoi për stabilizimin e gjendjes politike, ekonomike dhe sociale. Është e vetmja zonjë që u mundua të krijojë raporte dhe ura miqësore - lidhëse për qytetarët e kësaj pjese të Kosovës", ka thënë Gashi pas takimit.

Ai ka theksuar se Brukseli duhet ta shtrijë politikën konkrete në mënyrë që qytetarët e kësaj ane ta ndiejnë vetën të lirë. "Ajo më njoftoi se i vetmi faktor për stabilizimin dhe vendosjen e raporteve të shëndosha në këtë pjesë të Republikës së Kosovës janë ngritja e urave të shëndosha në mes të popullatës dhe zhvillimi ekonomik. Nga këtu nxora një konkluzion se bashkësia evropiane, në veçanti Brukseli, duhet ta shtrijë politikën e pastër dhe konkrete, që qytetarët ta ndiejnë vetën të lirë, pa dallim nacionaliteti, sepse qytetarët e kësaj pjese kanë shtetin e vet, Republikën e Kosovës dhe duhet të ndihen të lirë të jetojnë dhe veprojnë në këtë shtet", ka thënë Gashi, duke përgëzuar Hoxhiqin për punën e mrekullueshme që po bën me qytetarët e kësaj pjese.

ShSKUK-ja do t'i punësojë 103 mjekë specialistë të papunë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHKURT - Menaxhmenti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) pas analizës së kapaciteteve profesionale të klinikave të QKUK-së dhe spitaleve të përgjithshme, ka vendosur ta shpallë konkursin për pranimin e mbi 103 specialistëve të profileve të ndryshme mjekësore që aktualisht janë të papunë. Analiza e detajuar nga ShSKUK-ja ka konstatuar se nevojat më të mëdha për punësimin e specialistëve janë në spitalet e përgjithshme meqë mosha mesatare e mjekëve specialistë është e duke u vjetërsuar.

Në të kaluarën pa analiza të mirëfillta ishte përqendruar punësimi në QKUK.

Në Spitalin e Ferizajt do të punësohen 17 specialistë, përfshirë: dermatolog, fiziatër, gjinekolog-obstetër, infektolog, mjekësi interne, neonatologji, oftalmologji, otorinolaringologji, pediatri, radiologji, reumatologji, kardiologji dhe urologji. Konkursi do të shpallet edhe për pranimin e 16 specialistëve në Spitalin e Gjakovës për këto profile: biokimi klinike, dermatologji, fiziatri, gastroentorolopgji, gjinekologji-obstetrikë, kardiologji, mjekësi interne, mjekësi interne-endokrinologji, nenonatologji, oftalmologji, otorinolaringologji, radiologji dhe infektive.

Në Spitalin e Gjilanit do të punësohen tetë specialistë, përfshirë profilet: biokimi klinike, dermatovenerologji, fiziatri, gastroenterologji, gjinekologji me obstetrikë, mjekësi interne, reumatologji dhe toksikologji.

Për Spitalin e Mitrovicës do të shpallet konkursi për pranim e tetë specialistëve, përfshirë: biokimi klinike, gjinekologji me obstetrikë, mjekësi interne, pediatri, pulmologji dhe otorinolaringologji.

Ndërsa për Spitalin e Pejës do të shpallet konkursi për pranim të 15 specialistëve, përfshirë profile si: alergiologji me imunologji, biokimi klinike, dermatovenerologji, fiziatri, gjinekologji me obstetrikë, infektologji, kirurgji maksilofaciale, pediatri, radiologji dhe reumatologji.

Për nevoja të Spitalit të Prizrenit do të shpallet konkursi për 12 specialistë, përfshirë profilet si: dermatovenerologji, kardiologji, kirurgji maksilofaciale, kirurgji vaskulare, ortopedi, psikiatri e fëmijëve dhe radiologji. Në Spitalin e Vushtrrisë do të hapet konkursi për pranim të 14 mjekëve specialistë, përfshirë profilet: biokimi klinike, dermatovenerologji, fiziatri, gjinekologji me obstetrikë, mjekësi interne, mjekësi interne - endokrinologji, neonatologji, oftalmologji, otorinolaringologji, pediatri dhe radiologji.

Ministri Bytyqi takon ekspertin britanik, flasin për arsimin e lartë në Kosovë

PRISHTINË, 5 SHKURT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MAShT), Shyqiri Bytyqi, ka pritur të martën në takim ekspertin e projektit "HERAS", Bastian Baumann, me të cilin ka biseduar rreth arsimit të lartë në Kosovë. "E falënderova z. Baumann dhe ekspertët e tjerë në kuadër të projektit 'HERAS' për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë arsimit të lartë në përgjithësi dhe Agjencisë së Kosovës për Akreditim në veçanti, ndërsa theksova nevojën që kjo Agjenci të mbështetet edhe më tutje. Gjithashtu, me ekspertin Baumann biseduam edhe për procesin e vetëvlerësimit të udhëhequr nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, proces në të cilin kontribut të madh kanë dhënë edhe ekspertët e projektit 'HERAS'", ka thënë ministri Bytyqi pas takimit.

Invalidët dhe dëshmorët e UÇK-së kërkojnë rritjen e pensioneve

Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së përmes një shkrese ka kërkuar nga kryeministri Ramush Haradinaj t'i ngrehë pensionet e invalidëve të luftës së UÇK-së për 50 për qind. Kryetari i kësaj shoqate, Fadil Shurdhaj, ka thënë se rritja e fundit e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës së UÇK-së ka qenë në vitin 2011. Sipas tij, nga kjo kohë nuk ka pasur ndonjë rritje të pensioneve të kategorive të dala nga lufta, përkundër asaj që pensionet e kategorive të tjera janë rritur

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 5 shkurt - Shoqata e Invalidëve të Luftës e UÇK-së ka reaguar rreth Ligjit për paga dhe miratimit të buxhetit të Kosovës për vitin 2019. Kjo shoqatë e luftës ka fajësuar qeverinë që nuk i ka marrë për bazë kërkesat e tyre për rritjen e pensionit për invalidë. Sipas Shoqatës së Invalidëve të Luftës e UÇK-së, rritja e fundit është bërë në vitin 2011 nga Qeveria e atëhershme e drejtuar nga Hashim Thaçi.

Kryetari i Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, Fadil Shurdhaj, i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës, kryeministrit dhe ministrive përkatëse që t'i shqyrtojnë kërkesat e tyre. "Pas aprovimit të buxhetit të Republikës së Kosovës në Kuvend, dëshirojmë të sqarojmë për opinionin e gjerë, në veçanti për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, se, pavarësisht prej kërkesave tona të vazhdueshme për rritjen e pensioneve të familjeve të dëshmorëve dhe të invalidëve të luftës, një gjë e tillë nuk është paraparë me buxhetin për vitin 2019", ka thënë Shurdhaj.

Shoqata e Invalidëve të Luftës e UÇK-së i ka bërë kërkesë edhe kryeministrit Ramush Haradinaj për ngritje të pensioneve të invalidëve të UÇK-së. Këtë kërkesë Shoqata e Invalidëve të Luftës e UÇK-së e ka bërë më 14 janar të këtij viti.

"Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së kërkon nga Ramush Haradinaj, kryeministër i Republikës së Kosovës, që të ngrehen pensionet e invalidëve të luftës së UÇK-së për 50 për qind nga janari i vitit 2019", është thënë në kërkesën e kësaj shoqate.

Shurdhaj ka bërë me dije se si në kohën e qeverisë Mustafa, edhe



SHOQATA E INVALIDËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS
THE SOCIETY OF WAR INVALIDS MEMBERS OF THE KLA
PRISHTINË, Rr.UÇK nr.2 ,tel. 0382496 16
E-mail:shiluck99@hotmail.com

Për: z. Ramush Haradinaj , Kryeministër i Republikës së Kosovës
z. Skender Reçica, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale
CC: z. Gazmend Syla ,Zyra e Veteranëve të Luftës së UÇK-së
Nga: Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së

Nr. 12 Data 14.01.19

SHOQATA E INVALIDËVE TË LUFTËS TË UÇK-SË THE SOCIETY OF WAR INVALIDS MEMBERS OF THE KLA
Nr. 1008
Data 14.01.2019
PRISHTINË

Lënda: KËRKESË

Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së , kërkon nga z. Ramush Haradinaj – Kryeministër i Republikës së Kosovës qe te ngritën pensionet e Invalidëve te Luftës së UÇK-së, për 50 % nga janari i vitit 2019 .

Ngritje te pensioneve për invalid te luftës nuk ka pas nga viti 2010, andaj besojmë se kërkesa e jonë është e arsyeshme dhe do të shqyrtohet shpejtë dhe pozitivisht .

Me respekt SHIL të UÇK-së.

Prishtinë
14.01.2019

SHIL të UÇK-së
Sekretar Enver Krasniqi

tani çdo herë kanë deponuar kërkesa të protokolluara te zyra e kryeministrit por, përveç premtimeve verbale, deri më tani nuk kanë pasur ndonjë lëvizje pozitive. "Rritja e fundit e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës së UÇK-së ka qenë në vitin 2011. Nga ajo kohë nuk ka pasur ndonjë rritje të pensioneve të kategorive të dala nga lufta, përkundër asaj që pensionet e kategorive të tjera janë rritur. I bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës, kryeministrit dhe ministrive përkatëse, që t'i shqyrtojnë kërkesat tona dhe të bëjnë lëvizje pozitive në këtë drejtim", ka thënë Fadil Shurdhaj, kryetar i Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së.

Edhe në vitin 2017 përmes një shkrese, Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve i janë drejtuar në atë kohë kryeministrit Isa Mustafa me kërkesën për ngritjen e pensioneve për 50 për qind për këto dy kategori.

Komisioni hetimor: Dëbimi i gjashtë shtetasve turq përbën 31 shkelje kushtetuese dhe ligjore

Prishtinë, 5 shkurt - Komisioni Hetimor Parlamentar i Kuvendit të Kosovës, për rastin e dëbimit të shtetasve turq, ka identifikuar 31 shkelje ligjore gjatë procesit të arrestimit dhe dëbimit nga Kosova të gjashtë shtetasve turq, në mars të vitit 2018.

Kryetari i Komisionit Hetimor Parlamentar për rastin e dëbimit të shtetasve turq, Xhelal Sveçla, ka theksuar se shkeljen më të madhe e kanë bërë dy agjencitë kryesore të sigurisë në Kosovë. "Më 29 mars të vitit 2018, dy agjencitë kryesore për siguri në vend, me urdhrin e eprorit të tyre, bënë shkeljen më të madhe të sovranitetit të vendit tonë, nga vetë ata që duhet në mënyrë aktive ta mbrojnë, do të thotë AKI (Agjencia e Kosovës për Inteligjencë) dhe Policia e Kosovës, Komisioni parlamentar ka gjetur shkelje në çdo fazë të dëbimit që nga revokimi i lejeqëndrimeve e deri te dëbimi. Kemi gjetur 31 shkelje. Fakti që gjashtë turqit nuk ishin terroristë, shtrohet pyetja se përse janë dëbuar dhe pse me kaq urgjencë? Dëbimi pa kurrfarë urdhri të ligjshëm nuk ka qenë aksidental, por me dije të shtetit", ka thënë Sveçla. Sipas tij, në këtë rast janë bërë shkelje të njëpasnjëshme të Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, por edhe të konventave ndërkombëtare. Këto dy institucione të sigurisë, ka thënë Sveçla, kanë arrestuar gjashtë shtetas turq, me qëndrim të ligjshëm në Kosovë dhe i dorëzuan ata në duart e një Shërbimi të Jashtëm, duke kryer ekstradim të jashtëligjshëm të tyre. Ai ka shtuar se Komisioni ka gjetur shkelje në secilën fazë, që nga revokimi i lejeve të qëndrimit

për gjashtë shtetasit turq e deri te largimi i tyre nga Kosova.

Nënkryetari i këtij Komisioni Parlamentar, Driton Selmanaj, ka paralajmëruar se raporti i këtij komisioni do t'i dorëzohet Prokurorisë së Shtetit. "Ne nisemi nga një parim, pra që kushdo që ka informata për ekzistimin e një vepre penale dhe nuk e denoncon veprën penale, atëherë ai është bashkëpjesëmarrës në veprën penale ose ka kryer vepër penale", ka thënë Selmanaj.

Dëbimi nga Kosova i gjashtë shtetasve turq kishte nxitur reagime të ashpra në Kosovë, përfshirë edhe reagimin e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj.

Tre muaj pas ngjarjes, më 28 qershor të vitit 2018, Kuvendi i Kosovës pati themeluar Komisionin Hetimor Parlamentar lidhur me ndriçimin e rastit të dëbimit nga Kosova të gjashtë shtetasve turq.

Institucionet e Republikës së Kosovës i reagojnë Bashkimit Evropian (BE) për "Trepçën"

Haradinaj dhe Veseli thonë se 'Trepça' nuk

Kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryeparlamentari Kadri Veseli kanë reaguar ndaj deklaratës së zëdhënëses së Komisionit Evropian, Maja Kocijançiq, se "Trepça" duhet të jetë pjesë e dialogut. Haradinaj dhe Veseli kanë theksuar se me këtë gjuhë BE-ja është duke e rrënuar çdo perspektivë të dialogut dhe fqinjësisë së mirë. Sipas tyre, "Trepça" nuk është çështje e hapur në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kryeministri dhe kryeparlamentari kanë thënë se sot e përgjithmonë "Trepça" është e drejtë natyrore e shtetit të Kosovës. Ndaj kësaj deklarate kanë reaguar edhe liderët e partive opozitare

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 SHKURT - Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Maja Kocijançiq, është cituar të martën nga agjencia serbe e lajmeve "Tanjug" rreth ecurisë së dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë pas miratimit të statutit të "Trepçës" nga Kuvendi i Kosovës. Sipas kësaj agjencie, Kocijançiq ka theksuar se "të gjitha çështjet ndërmjet dy palëve duhet të zgjidhen përmes finalizimit të dialogut". Ndaj kësaj deklarate ka pasur reagime të zyrtarëve të Republikës së Kosovës.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se reagimi i BE-së kundër miratimit të statutit të "Trepçës" nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është dëshmi se BE-së i ka humbur rruga në oborr. "Deklarata e zëdhënëses së Komisionit Evropian, Maja Kocijançiq, dhënë mediave serbe, se 'Trepça' duhet të jetë pjesë e dialogut, është qëndrim i papresedan, i papranueshëm dhe, si i tillë, cenon sovranitetin e shtetit të Kosovës", ka thënë Haradinaj.

Ai ka theksuar se "Trepça" nuk është çështje e hapur në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Në asnjë moment populli i Kosovës dhe institucionet e saj nuk do ta lejojnë krijimin e temave false që kanë qartazi qëllim ndarjen e Kosovës", ka deklaruar Haradinaj.

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka theksuar se "Trepça" as nuk ka qenë, as nuk është dhe as nuk do të jetë çështje e hapur në dialogun me Serbinë. "Me këtë gjuhë, BE-ja është duke e rrënuar çdo perspektivë të dialogut dhe fqinjësisë së mirë. 'Trepça' është e drejtë natyrore e shtetit të Kosovës. Sot dhe përgjithmonë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndaj deklaratës së Kocijançiqit ka reaguar edhe kryetari i LDK-së, Isa Mustafa. Ai ka thënë se është

Bashkëpunimi me BERZh-in do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të Kosovës

PRISHTINË, 5 SHKURT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, me bashkëpunëtorë, ka pritur të martën në takim një delegacion nga bordi i drejtorëve i Bashkës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), me të cilin ka biseduar për investimet e deritanishme të kësaj banke në vendin tonë. "Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim mbetet partnerja strategjike e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Me delegacionin e bordit të drejtorëve të BERZh-it diskutuam mbi investimet e deritashme të kësaj banke në Kosovë dhe për projektet zhvillimore në periudhën e ardhshme. Thellimi i bashkëpunimit me BERZh-in për realizimin e projekteve infrastrukturore, të energjisë së ripërtërishme, minierave, zhvillimin e sektorit privat, nëpërmjet financimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës", ka thënë Haradinaj pas takimit.

do të jetë pjesë e dialogut në Bruksel

habitur nga kërkesa e Bashkimit Evropian që çështja e "Trepçës" të trajtohet në dialogun me Serbinë. "Më habiti kërkesa e BE-së që çështja e 'Trepçës' të trajtohet në dialogun me Serbinë. Kosova në asnjë fazë nuk ka pranuar që për 'Trepçën' dhe pasuritë e saj natyrore, të cilat janë në territorin e saj, të dialogojë me Serbinë. Është kjo një kërkesë absurde dhe e papranueshme, ashtu siç është e papranueshme që me Serbinë të dialogohet për kufijtë dhe për territorin e Kosovës", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka theksuar se kur ishte kryeministër, qeveria nën drejtimin e tij ka përgatitur dhe aprovuar Ligjin për "Trepçën", siç ka thënë ai, "duke e shpëtuar këtë simbol ekonomik të vendit nga falimentimi dhe privatizimi". Mustafa ka shtuar se deputetët e LDK-së votuan para disa ditësh statutin e "Trepçës", i cili mori 2/3 e votave në Kuvend. "Kjo flet për unitetin tonë karshi interesave jetike të vendit. Duhet të jemi bashkë dhe fuqishëm të kundërshtojmë që në emër të marrëveshjes gjithëpërfshirëse me Serbinë të dialogojmë çështjet e sovranitetit dhe integritetit tonë shtetëror. Çështjet e shtetësisë sonë. Sepse, kështu si kanë filluar, një ditë do të kërkojnë që edhe frymë mos të marrim pa e dialoguar me Serbinë!", ka thënë Mustafa.

Sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka thënë se deklarata e Kocijanciqit ka kaluar çdo kufi të asaj që një mendje e shëndoshë mund të perceptojë këto relacione. Sherifi e ka cilësuar absurde kërkesën e një përfaqësuese të BE-së që për resurset e veta Kosova të vendosë në tryezë të dialogut me Serbinë. Sherifi ka thënë se qëndrimet e tilla cenojnë rëndë sovranitetin e Kosovës dhe nxjerrin në pah legjitimitetin e brishtë të institucioneve të BE-së si ndërmjetësuese në dialogun Kosovë - Serbi. "Është detyrë urgjente e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës t'i alarmojë qarqet ndërkombëtare se kjo qasje cenon integritetin dhe sovranitetin e Kosovës dhe, si e tillë, nxitë konflikte të reja në Ballkan", ka shkruar Sherifi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se vendimi i Kuvendit të Kosovës për "Trepçën" është një vendim sovran për resurset natyrore të shtetit të Kosovës. Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar ndaj kësaj deklarate që "Trepça" të bëhet pjesë e dialogut me Serbinë në Bruksel. "Nuk ka vonuar shumë e BE-ja përmes kasnecëve që përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e Serbisë në Kosovë, duke ndërhyrë në mënyrë flagrante në punët e brendshme të një shteti sovran dhe të pavarur, ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Kosovës për statusin e 'Trepçës', duke kërkuar që kjo çështje të bisedohet në Bruksel e që është no sens i llojit të vet e që nuk do ta pranonte asnjë shtet normal", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së.

Javën e kaluar me 80 vota për, dy kundër dhe tri abstenime, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar për statutin e "Trepçës" si shoqëri aksionare. Statuti i aprovuar i "Trepçës" mundëson zbatimin e Ligjit për "Trepçën" si dhe adreson çështjet kryesore për konstituimin dhe funksionalizimin e ndërmarrjes, siç janë: Regjistrimi formal administrativ i "Trepçës" si Shoqëri Aksionare, Kompletimi i Bordit Mbikëqyrës siç parashihet me Ligjin mbi "Trepçën", Zgjedhja dhe emërimi i Bordit Menaxhues, si dhe fillimi i investimeve siç parashihet me Ligjin mbi "Trepçën".

OEAK-u: Ngritja e vazhdueshme e pagave në sektorin publik kërcënon stabilitetin buxhetor

Prishtinë, 5 shkurt (ER) - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka shprehur shqetësimet e saj lidhur me kalimin e projektligjit për paga dhe rritjen e shpenzimeve buxhetore për paga. "Oda Amerikane përsërit qëndrimin e saj se rritja e mëtejme e pagave për sektorin publik rrit dallimet në nivelet e pagesave ndërmjet sektorëve publikë dhe privatë, në disfavor të sektorit privat, i cili në të njëjtën kohë është shtylla e mbushjes së buxhetit si dhe zhvillimit ekonomik", është bërë me dije në komunikatën e kësaj ode.

Oda Amerikane beson se veprimet si këto të institucioneve shtetërore, pa konsideratë për ngarkesat mbi sektorin privat, janë në kundërshtim me diskursin e zyrtarëve më të lartë të shtetit për fuqizim të sektorit privat dhe nxitje të investimeve. "Ngritja e pagave për sektorin publik është goditje e drejtpërdrejtë për ndërmarrjet private, e posaçërisht për sektorin edhe ashtu të brishtë të prodhimit, por edhe për rritjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta për shkak se fuqia punëtore nuk do të mund të promovohet më tej si përparësi konkurruese e Kosovës. Kalimi i projektligjit për paga kërcënon stabilitetin financiar të vendit për shkak të rritjes enorme të shpenzimeve për paga dhe skema sociale, në dëm të investimeve kapitale, por edhe për shkak se rrezikon ta thellojë deficitin buxhetor", është theksuar në komunikatën e Odës Amerikane.

Sipas Odës Amerikane, në të njëjtën kohë, marrja e vendimeve me efekte afatgjata, në kushte të presionit, pa dialog gjithëpërfshirës, përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e sektorit privat, cenon prospektet e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. "Institucionet e vendit, Qeveria dhe Kuvendi duhet të përmbahen nga vendimet si këto, por edhe paralajmërimet për vendime të tjera, të cilat Oda Amerikane i konsideron si ndërhyrje në sektorin privat, në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, si dhe orientimin e Kosovës për fuqizimin e ekonomisë funksionale të tregut", është theksuar në këtë komunikatë.

Nis sanimi i përkohshëm i gropave në rrugët e Gjilanit

Gjilan 5 shkurt (ER)- Drejtoria e Shërbimeve Publike në Gjilan ka filluar sanimin e përkohshëm të gropave me kubëza në disa lagje të qytetit. Drejtori i kësaj drejtorie, Naser Korça, ka deklaruar se sanimi i përkohshëm i gropave po bëhet derisa të krijohen kushtet atmosferike për asfaltim të rrugëve. "Këtë po e bëjmë për t'iu krijuar mundësi qarkullimi më të mirë qytetarëve tanë. Do t'i sanojmë të gjitha gropat në qytet, ndërkaq sapo të krijohen kushtet atmosferike, do ta fillojmë ndërtimin e rrugëve në kuadër të programit 'Gjilani 2019 plus'. Është përkushtim i kryetarit Haziri që ta heqim lloçin dhe vadat", ka thënë Korça.

I pari i Shërbimeve Publike në Gjilan ka konfirmuar se janë të parapara projektet multimilionëshe në infrastrukturë të cilat pritet të fillojnë së shpejti.

Sabri Beqirit nga Vushtrria i kthehen paratë pasi është evidentuar si rast skamnor

Vushtrri, 5 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka bërë me dije se paratë të cilat ia ka paguar Këshillit të Bashkësisë Islame, qytetari Sabri Beqiri, në emër të anëtarësisë, i janë kthyer pasi është evidentuar si rast skamnor. Ai ka treguar se për këtë çështje të martën ka takuar udhëheqësit e Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri, me ç'rast është sqaruar se komuna ka kryer të gjitha obligimet e parapara. "Rasti i Sabri Beqiri dhe afër 100 familje të tjera në Vushtrri ndihmohen rregullisht nga KBI me miell dhe pako të tjera ushqimore në kuadër të programeve humanitare. Si duket deri te mosmarrëveshja për pagesën prej 417 eurosh ka ardhur për shkak të moskomunikimit të duhur qytetar-KBI", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook". Sabri Beqiri është dashur t'i paguajë 417 euro për anëtarësi Bashkësisë Islame në Vushtrri për ta varrosur nënën e tij, edhe përkundër se ai kishte deklaruar se është rast social.

Do të restaurohet kulla e Ramë Bllacës

Therandë, 5 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se do të restaurohet shtëpia kullë e veprimtarit Ramë Bllaca. Ai ka thënë se me restaurimin e kësaj kulle do të rritet edhe numri i vizitorëve të cilët do të mund ta njohin për së afërmi historinë e veprimtarit Bllaca. "Angazhimi ynë është serioz dhe jemi të interesuar që ai projekt të përfundojë dhe të ketë respektin e merituar, duke qenë i vizituar në të ardhmen nga gjeneratat e ardhshme dhe turistët, për t'u njohur me historinë tonë", ka thënë Muharremaj.



Komuna e Prizrenit mundëson falas kastrimin e qenve shtëpiakë

Prizren, 5 shkurt (ER) - Komuna e Prizrenit ka njoftuar të gjithë qytetarët e saj se mund t'i kastrojnë falas qentë e tyre. "Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit, të cilët janë pronarë të qenve, që qentë e tyre mund të kastrohen apo sterilizohen falas. Nëse bëni sterilizimin e qenit tuaj, gjithashtu falas ofrohet vaksinimi, dehelmetizimi dhe vendosja e çipit identifikues. Në qoftë se qeni juaj është rëndë i sëmurë, me eutanazi i ndihmohet që në mënyrë mjekësore dhe humane të pushojë lehtë, shpejt dhe pa dhimbje", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.

Kjo komunë ka bërë me dije se kastrimi i qenve bashkorganizohet nga organizata ndërkombëtare "Stray Coco", Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve dhe "Kosovo Small Animal Welfare". "Për më shumë informata kontaktoni në numrin 049 714 124", ka njoftuar kjo komunë.

A duhet të vazhdojë dialogu në Bruksel?

Jakup KRASNIQI

Prej se kanë filluar bisedimet politike të Brukselit në mes të Prishtinës dhe Beogradit, Brukseli zyrtar më se një herë ka anuar haptas në mbrojtje të politikave gjenocidale të Serbisë. Pothuajse në asnjë rast gjatë gjithë këtyre viteve nuk ka reaguar ndaj politikave agresive të pasardhësve të Millosheviqit?! Natyrisht, për këtë çështje nuk janë fajtorë vetëm në Bruksel. Fajtori kryesor është në Kosovë dhe janë të gjithë ata që i filluan bisedimet politike dhe të gjitha ata që e votuan marrëveshjen e 19 prillit 2013.

Në ato marrëveshje që vazhduan edhe më pastaj, përfaqësuesit e Kosovës në ato bisedime pranuan të bisedojnë për statusin e saj të zgjidhur gjatë bisedimeve të Vjenës dhe me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe të konfirmuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Siç po shihet, zyrtarët e BE-së as pas 11 vjetëve nuk janë duke i analizuar as dokumentet që i kanë prodhuar zyrtarët e BE-së. Kjo shihet nga deklarata e zëdhënëses së BE-së, zonjës Kocijançiq, e cila paska deklaruar: "Bashkimi Evropian, si ndërmjetësues i dialogut, ka për qëllim që të gjitha çështjet e hapura ndërmjet dy shteteve t'i zgjidhë nëpërmjet një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e raporteve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës".

Të gjithë e dimë se bisedimet në fillimin e tyre janë bërë, duke pasur parasysh Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së "për ta lehtësuar qarkullimin e lirë dhe lehtësinë e qytetarëve të të dy vendeve". Ndërsa reagimi paska ardhur për shkak të rregullimit të statusit të "Trepçë"-s. Ndërsa pasuria e Kosovës nuk duhet të rinegociohet pasi ajo është çështje e kryer në vitet 2006-2008.

Të përfundojmë: Të gjitha "argumentet" që po i dëgjojmë këto ditë dhe të gjitha presionet ndaj Kosovës janë në adresë të gabuar. Sigurisht se për këtë gjendje përgjegjësia është te faktori politik shqiptar i cili nuk po gjënë forcë që të formësojë asnjë politikë unifikuese për vendin e vet.

Kjo gjendje sikur po e kërkon një pushim në dialog!

Grabitje e armatosur në një filiale banke në Çagllavicë

Çagllavicë, 5 shkurt (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se të martën rreth orës 15:00 ka marrë informatën për një grabitje të armatosur. Grabitja ka ndodhur në filialin e një banke që gjendet në Çagllavicë. "Menjëherë pas marrjes së këtij informacioni strukturat rajonale për hetimin e krimit kanë filluar ndërmarrjen e një varg veprimesh operative dhe hetimore. Mbështetur në rezultatet e para të grupit hetimor që po zhvillon hetimet lidhur me rastin në fjalë, dyshohet se kjo grabitje është realizuar nga katër persona të dyshuar dhe të armatosur", është thënë në njoftimin për media të Policisë së Kosovës.

Bëhet me dije se të dyshuarit pas grabitjes janë larguar nga vendi i ngjarjes me një veturë e cila është identifikuar nga policia. Aktualisht policia po punon me përkushtim për t'i identifikuar të dyshuarit dhe vendndodhjen e tyre.

Mjekët kirurgë në Kosovë vazhdojnë grevën

Prishtinë, 5 shkurt - Mjekët kirurgë në Kosovë po vazhdojnë grevën edhe pas miratimit të Ligjit për Pagat nga Kuvendi i Kosovës. Me ligjin e ri është rritur edhe koeficienti për mjekët nga 3.5 sa ka qenë, në 5. Megjithatë, mjekët kirurgë kërkojnë të radhiten me koeficient më të lartë.

Arbër Morina, kirurg, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se greva do të vazhdojë edhe më tej, me kërkesën për rregullimin e koeficientit. "Greva vazhdon njësoj, pa kurrfarë ndryshimi, me të njëjtën kërkesë dhe me të njëjtin ritëm. Ne po kërkojmë rregullimin e koeficientit dhe rishikimin e ligjit, për faktin se me ligjin e fundit të miratuar në Kuvend kemi konstatuar shkelje të rënda në procedura dhe në përmbajtje, të cilat bien ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ne mendojmë se ky ligj duhet të rishikohet dhe të riformulohet", ka thënë Morina.

Mjekët kirurgë e kanë nisur grevën më 17 dhjetor të vitit të kaluar dhe, pavarësisht prej thirrjeve për ndërprerje të saj nga ana e Federatës Sindikale të Shëndetësisë, greva vazhdon.

Bahtiri dhe Tahiri e vlerësojnë të nevojshëm projektin 'Trajtimi i ujërave të zeza'

Mitrovicë, 5 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të martën në takim kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, me të cilin ka biseduar lidhur me projektin e impiantit "Trajtimi i ujërave të zeza", në mënyrë që në këtë projekt të përfshihet edhe Vushtrria.

Gjatë këtij takimi të dy kryetarët janë pajtuar që t'i drejtohen Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik përmes një kërkese për përfshirjen e Komunës së Vushtrrisë në projektin "Trajtimi i ujërave të zeza". Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka falënderuar Tahirin për gatishmërinë e treguar për realizimin e këtij projekti, duke thënë se ky projekt është shumë i rëndësishëm jo vetëm për Komunën e Mitrovicës, por edhe atë të Vushtrrisë.

Bahtiri ka thënë se qëllimi i projektit "Trajtimi i ujërave të zeza" është që ta përmirësojë ndjeshëm mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të zeza në qytetin e Mitrovicës dhe atë të Vushtrrisë. Sipas tij, një gjë e tillë do të kontribuojë në mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore dhe të ujërave nëntokësore në zonën e projektit, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë.

Ndërsa kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka ofruar mbështetjen e tij të plotë për realizimin e këtij projekti. Pas këtij takimi, Bahtiri e Tahiri kanë vizituar Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Uniteti Sh.A' në Mitrovicë, me ç'rast janë pritur nga kryeshefi ekzekutiv i kësaj kompanie, Gazmend Morina. Gjatë këtij takimi është diskutuar për vështirësitë e kompanisë publike si dhe për borxhin që ka trashëguar menaxhmenti i ri nga ai paraprak.

Mitchell: Marrëveshja e Prespës ndikon në stabilitetin e rajonit

Uashington, 5 shkurt - Ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë në largim, Wess Mitchell, ka vlerësuar se Marrëveshja e Prespës dhe anëtarësimi i ardhshëm i Maqedonisë në NATO janë momente historike, të cilat do të kenë ndikim pozitiv në stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit. "Arritja e Marrëveshjes së Prespës dhe hyrja e saj në fuqi, e shoqëruar me anëtarësimin në NATO, janë momente historike të arritjeve të jashtëzakonshme me të cilat Maqedonia duhet të krenohet", tha Mitchell në një bisedë me kreun e diplomacisë maqedonase, Nikolai Dimitrov në Uashington.

Ministra e Punëve të Jashtme e Maqedonisë ka njoftuar se ministri Dimitrov e ka njoftuar zyrtarin e Departamentit të Shtetit, Wess Mitchell, lidhur me aktivitetet e ardhshme rreth ratifikimit të Protokollit të anëtarësimit të Maqedonisë në NATO.

Ministri Dimitrov shfaqi shpresën se ratifikimi i këtij dokumenti nga ana e Senatit amerikan do të ndodhë shumë shpejt.

Shefi i diplomacisë maqedonase po qëndron në Uashington ku përveç takimeve më zyrtarë të lartë të administratës amerikane do të marrë pjesë edhe në takimin ndërministrorë të koalicionit në luftën kundër "Shtetit Islamik".

Pritshmëritë për fjalimin e presidentit Trump para Kongresit

Presidenti amerikan Donald Trump në fjalimin e tij drejtuar kombit pritet të paraqitet si një lider i fortë që po përmbush premtimet e fushatës së tij, ta lavdërojë gjendjen e ekonomisë amerikane dhe të këmbëngulë për nevojën për një pengesë fizike në kufirin e ShBA-së me Meksikën

Uashington, 5 shkurt - Presidenti Donald Trump pritet ta lavdërojë gjendjen e ekonomisë amerikane dhe të këmbëngulë për nevojën për një pengesë fizike në kufirin e Shteteve të Bashkuara me Meksikën në fjalimin e tij të martën në mbrëmje mbi gjendjen e vendit. Fjalimi i presidentit Trump ishte planifikuar fillimisht për më 29 janar, por u shty për në 5 shkurt për shkak të mbylljes më të gjatë të Qeverisë në histori amerikane, të shkaktuar nga mosmarrëveshjet mes presidentit republikan dhe shumicës demokratike në Kongres mbi financimin për ndërtimin e një muri në kufi. Një debat në Senat të hënën dha sinjalet e asaj që mund të pritet nga fjalimi i presidentit Trump.

Presidenti Trump pritet të paraqitet si një lider i fortë që po përmbush premtimet e fushatës së tij. Udhëheqësi i shumicës në Senat, Mitch McConnell la të kuptohet se suksesi i ekonomisë amerikane mund të jetë tema kryesore e fjalimit. "Politikat pro-rritjes ekonomike dhe profamiljes të republikanëve kanë ndihmuar krijimin e vendeve të punës dhe gjallërimin e bizneseve të vogla, ndërsa familjet e klasës së mesme në mbarë vendin vazhdojnë të përfitojnë nga këto politika", tha ai.

Demokratët janë të përgatitur të përgjigjen, siç treguan komentet e udhëheqësit të pakicës në Senat, Chuck Schumer. "Të martën, presidenti do të thotë, siç pritet, se gjendja e vendit tonë është e fortë, por e vërteta është se gjendja e ekonomisë së krijuar nga Trumpi po dobësون klasën e mesme amerikane. Gjendja e sistemit të kujdesit shëndetësor është duke dobësuar familjet amerikane dhe administrata Trump është e përfshirë në kaos dhe paaftësi", tha Schumer.

Presidenti Trump e ka pranuar se mund të mos jetë në gjendje të marrë mbështetje të mjaftueshme në Kongres për të financuar ndërtimin e një muri kufitar - premtimi i tij kryesor gjatë fushatës. Ai ka thënë se mund të deklarojë një emergjencë kombëtare për të marrë fondet e nevojshme dhe mund ta përdorë fjalimin mbi gjendjen e vendit për të nxitur këtë mundësi. Senatori Lindsay Graham u ka kërkuar republikanëve të tjerë që ta mbështesin presidentin. "Nëse demokratët nuk do të punojnë me të, mendoj se do të ishte gabim për republikanët ta sabotojnë presidentin, nëse ai përpiqet të vendosë barrierat në vend, duke përdorur autoritetin e tij si komandant i forcave të armatosura", tha Graham.

Presidenti Trump gjithashtu ka gjasa të deklarojë suksesin në ndërmjetësimin e Shteteve të Bashkuara në Afganistan, si një justifikim për t'i dhënë fund angazhimit 17-vjeçar amerikan në atë vend. Rand Paul, një senator republikan nga Kentaki, është gjithashtu një mbështetës i pasionuar i tërheqjes së trupave amerikane nga Siria dhe Afganistani. "Ne jemi fitimtarë, në çdo aspekt. Kemi vrarë bin Ladenin, kemi ndërprerë kampet terroriste në Afganistan. A është Afganistani me probleme? Sigurisht, është dhe do të jetë i tillë", tha Paul.

Por disa ligjvënës nga të dyja partitë e kundërshtojnë tërheqjen nga Afganistani. "Një nga kolegët tanë, senatori nga Florida Marco Rubio, tha se terrorizmi është si një tumor, si kancer. Mund të përpiqemi ta eliminojmë atë, por nëse nuk jemi të suksesshëm në eliminimin e tij, edhe pse e kemi zvogëluar, ai do të rikthehet sapo të të ulet presioni", tha ai.

Presidenti Trump pritet gjithashtu të thotë se ka pasur përparim në negociatat tregtare të administratës së tij me Kinën dhe bisedimet me Korenë e Veriut për çnuklearizimin e Gadishullit Korean.

Papa Françesku vazhdon vizitën në Emiratet Bashkuara Arabe

Abu Dabi, 5 shkurt - Papa Françesku mbajti një tubim historik për rreth 170 000 katolikë në një stadium në Abu Dhabi, kryeqytetin e Emirateve të Bashkuara Arabe.

Kreu i Kishës Katolike udhëtoi me veturën e hapur në Stadiumin "Zayed" ku u ngre një altar me një kryq të madh. Papa Françesku u prit ngrohtësisht nga filipinasit dhe indianët katolikë të cilët përbëjnë pjesën më të madhe të fuqisë punëtore në Emiratet e Bashkuara Arabe.

Emiratet e Bashkuara Arabe e ftuan Papën për vizitë treditore si pjesë e organizimit "Viti i tolerancës 2019". Papa Françesku u kërkoi udhëheqësve fetarë që të punojnë së bashku për ta hedhur poshtë "pangopësinë e mjerueshme" të luftës dhe t'i rezistojnë logjikës së fuqisë së armatosur, armatosjes së kufijve dhe ngritjes së mureve.

BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.

E rrallë

Djali përdor peshkaqenin për të tymosur

Një djalë ka filmuar veten duke tymosur nëpërmjet një peshkaqeni të vogël. Pamja shokuese është xhiruar në anijen e peshkimit në New South Wales. Djali mbante peshkaqenin që ka dy tuba, ku me njërin ndez tobakon dhe me tjetrën e thith dhe nxjerr tym. Video është shpërndarë në një faqe në "Facebook" me 21 mijë ndjekës.

FOTO E DITES

Një pamje që tregon perëndimin e diellit në Detin Mesdhe në Marsejë, në Francën jugore. /AFP/

E jashtëzakonshme

Veza që theu rekordin në 'Instagram'

Fotografia e një veze që theu rekordet e "Instagram"-it, duke u renditur si fotografia më e pëlqyer në botë, është pjesë e një fushate ndërgjegjësimi për shëndetin mendor. Veza tani është plasaritur, pasi "ndjen presionin" e të gjithë vëmendjes që ka marrë. Një mesazh i postuar së bashku me vezën e thyer këshillon njerëzit të kërkojnë ndihmë nëse ata ndihen në të njëjtën mënyrë. Më shumë se 52 milionë njerëz kanë pëlqyer tashmë pamjen origjinale e cila u postua në janar.

BARSOLETA E DITËS

Shkon polici në dyqan:
- M'i jep dy kilogramë molla.
- Të kuqe a të verdha i do?, e pyet shitësi.
- Çfarë të duash, sepse i qëroj para se t'i ha.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Jeni pak të ndjeshëm dhe ndiheni keq kur dikush ju kap të papërgatitur. Me njerëz të rinj nuk ndiheni aq shumë në humor.

DEMI
Edhe pse mendoni se jeni më të mirët, bëni mirë të riktheheni me këmbë në tokë, përpara se një eprori juaj ta bëjë këtë gjë.

BINJAKËT
Edhe pse sot do t'ju ofrohen disa alternativa, mos i merrni të gjitha të mirëqena. Është mirë t'i vlerësoni në detaje ato që vendosni.

GAFORRJA
Sot do t'ju ofrohen mundësi që nuk duhet t`i nënvlerësoni aspak, sidomos sa i përket aspektit të karrierës.

LUANI
Nëse dëshironi që personat që keni pranë të bëjnë diçka që ju përfshin dhe ju, bëni mirë që të bashkëpunoni me ta duke lënë mënjanë paragjykimet.

VIRGJËRESHA
Ndryshimet tuaja të humorit mund të bien në sy sot përgjatë ditës. Dikush do t'ju kërkojë të jeni më racional.

PESHORJA
Sot mund të mos merreni shumë me detajet që ju zënë zakonisht gjysmën e ditës. Ndonjëherë gjërat janë shumë më të thjeshta sesa që mendoni.

AKREPI
Nëse sot doni të merreni me diçka, nuk ka gjë më të mirë se aktivitetet kreative. Do të qetësoheni menjëherë.

SHIGJETARI
Sot lërini mënjanë ëndrrat dhe mundohuni t'i përshtateni sa më shumë realitetit. Për t'i zgjidhur dilemat tuaja pyesni një mik.

BRICJAPI
Nëse dikush do t'ju bëjë pyetje sot, është mirë t'i përgjigjeni. Sinqeriteti mund të ndihmojë shumë marrëdhënien tuaj.

UJORI
Sot do të zgjidhni vetëm ato gjëra që ju pëlqen të bëni. Për të tjerat nuk doni të interesoheni fare.

PESHQIT
Planet tuaja për sot mund të shkojnë përtej asaj që keni menduar. Qëndroni të gatshëm për gjithçka që ju rezervon dita.

Chloe Moretz festoi ditëlindjen me Rita Orën

Chloe Moretz dhe vëllai i saj Colin festuan ditëlindjen në Las Vegas. Aktorja 22-vjeçare dhe vëllai i saj kishin një tortë mahnitëse para vetes. Pas darkës në restorantin më të mirë, ata festuan në një vend VIP me shumë të pranishëm. Edhe Rita Ora ishte e pranishme.

Aktorja e njohur kineze rikthehet në rrjetet sociale

Aktorja kineze, Fan Bingbing, është rikthyer në rrjetet sociale, pas një pauze që nga maji i vitit 2018. Ajo ka bërë dy postime në gjuhën kineze që përkthehen 'Gëzuar Vitin e Ri! Shumë shëndet! Ju dua". Ka qenë një periudhë e vështirë për 37-vjeçaren, për të cilën thuhet se kishte borxh 128 milionë dollarë në taksa, tarifa dhe gjoba shtesë.

Shakira pret flokët karakteristike

Pamje e re për këngëtaren kolumbiane. Shakira ka prerë flokët karakteristike duke ardhur me një stil shumë më ndryshe. Kaçurrelat e saj tanimë janë shkurtuar dhe i kanë dhënë këngëtares një pamje më të freskët. Ndryshimi i saj ra në sy derisa ishte rrugëve në Barcelonë.

Jason dhe Brittany bëhen sërish prindër

41-vjeçari Jason Aldean dhe e dashura e tij Brittany, kanë mirëpritur në jetë një vajzë e cila quhet Navy Rome Williams. Ka qenë këngëtari ai i cili njoftoi lajmin përmes "Instagram"-it. "Sot familja jonë është kompletuar me ardhjen në jetë të vajzës sonë Navy Rome", ka shkruar Jason. Edhe Brittany hyri në të njëjtin rrjet social për të shkruar: "Ne kemi mirëpritur sot vajzën tonë. Të duam shumë vogëlushe".

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	WEST BROM - BRIGHTON	1	EVERTON - MAN CITY	X-2	HEARTS -LIVINGSTON	1

Gashi: Kosova do të fitojë medalje në Lojërat Olimpike

Ministri i Sportit, Kujtim Gashi, në ceremoninë e ndarjes së bursave për shpresat olimpike, ka thënë se Kosova do të fitojë medalje të artë në Lojërat Olimpike. "Viti 2018 ka qenë një nga vitet më të mira që nga paslufta dhe besoj se në vitin 2020 do ta kemi medaljen e artë në Lojërat Olimpike në Tokyo", ka thënë ministri Kujtim Gashi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 5 shkurt - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, të martën ka bërë ndarjen e vendimeve të bursave për shpresat olimpike. Këto bursa ndahen për vitin 2019, pas propozimeve nga federatat përkatëse dhe rekomandimeve nga Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK), kurse sportistët përfitues të bursës do të marrin nga 150 euro në çdo muaj.

Ministri Gashi ka thënë se kjo tregon më se miri për punën që po bëjnë institucionet shtetërore për talentet në sport, të cilët ministri i ka vlerësuar si ambasadorët më të mirë të shtetit të Kosovës. "Kjo ceremoni tregon përkushtimin tonë si Ministri, por edhe si Qeveri për t'i ndihmuar talentët tanë që janë shpresë jonë. Pas mbështetjes që ka bërë Komiteti Olimpik është momenti që edhe ne ta tregojmë kujdesin tonë të drejtpërdrejtë, sepse ju jeni ambasadorë të shtetit. Kjo është një mbështetje simbolike në raport me angazhimin e juaj, por ne do të jemi edhe në momente dhe rrethana të tjera për t'iu mbështetur dhe përkrahur. Viti 2018 ka qenë një nga vitet më të mira që nga paslufta dhe besoj se në vitin 2020 do të kemi medaljen e artë në Lojërat Olimpike në Tokyo", ka thënë ministri Gashi.

I pranishëm në ceremoninë e ndarjes së bursave ishin edhe kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj. Hasani është optimist se këta bursistë në të ardhmen do të kenë rezultate të mëdha dhe shpërblimet do të rriten edhe më shumë. "Është shumë simbolike, por duke u nisur nga mosha e tyre, besoj se ata do të përparojnë dhe me rezultatet e tyre do të rritet edhe më tutje mbështetja për ta", ka deklaruar Hasani.

Shpresat olimpike që janë përfitues të bursës nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë: Albina Deliu (Atlete), Arbi Pupovci (Skitar), Arlind Selimi (Mundës), Betim Maliqi (Karateist), Dren Ukiemraj (Notar), Erza Muminoviq (Xhudiste), Fatih Karabaxhaku (Pingpongist), Muhamet Ramadani (Atlet), Patriot Behrami (Boksier) dhe Shpat Zeka (Xhudist).

SHKURT

Mutlugili viziton Kosovën

Zëvendëspresidenti i Konfederatës Evropiane të Volejbollit (CEV), Ozkan Mutlugil, do ta vizitojë Kosovën për herë të parë. Ai do të qëndrojë në një vizitë dyditore në Prishtinë. I dyti i volejbollit evropian, i cili është njeriu i parë i thesarit në CEV, pritet të arrijë në Kosovë në mbrëmjen e 14 shkurtit. Më 15 shkurt ai do të jetë në ceremoninë e laureatëve të volejbollit të Kosovës dhe në të njëjtën kohë do të marrë pjesë në ndeshjen në mes të Përfaqësueses A të Kosovës dhe Kombëtares së Shqipërisë. Ardhja e njeriut të dytë të volejbollit evropian tregon edhe një herë mbështetjen e parezervë që CEV e ka për anëtaren e 56, Kosovën.

Liria prezanton dy transferimet e fundit për pranverë

Skuadra e Lirisë nga Prizreni ka prezantuar edhe dy transferime për sezonin pranveror në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Klubi nga Prizreni ka njoftuar se Robby Norales nga Hondurasi dhe Armando Vargas nga Kolumbia janë dy futbollistët që e përmbyllin afatin dimëror të transferimeve.

Topilla transferohet nga Prishtina

Klubi i Futsallit Prishtina ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me lojtarin Dardan Topilla, i cili karrierën e filloi në klubin FC Feniks, ku edhe arriti të shpallet kampion për dy vjet, si dhe ishte pjesë e garave evropiane në UEFA Futsal Champions League. Topilla është edhe pjesë e Përfaqësueses së Kosovës, ku në kualifikimet për Botërorin FIFA Futsal World Cup 2020 ishte një nga lojtarët kryesor, duke shënuar dy gola. Aktualisht, ai nga Federata e Futbollit të Kosovës është shpallur lojtari më i mirë i futsallit.

Lëndimi i Mustafit nuk është serioz

Lëndimi i qendërmbrojtësit shqiptar, Shkodran Mustafi, nuk është serioz, kurse ai do të jetë i gatshëm për ndeshjen e radhës në Premierë Ligë. Lajmin e ka konfirmuar trajner i Arsenalit, Unai Emery. "Mendoj se Mustafi është mirë dhe nuk ka asgjë serioze. Pres që ai të jetë i gatshëm për ndeshjen që na pret", ka thënë Emery. Skuadra e Arsenalit pësoi humbje në derbi ndaj Manchester Cityt (3-1).

Drejtuesit e FFK-së shkojnë në Romë për Kongresin e UEFA-s

Prishtinë, 5 shkurt - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, kanë mbërritur sot në Romë, ku do të marrin pjesë në Kongresin e 43-të të UEFA-s, i cili i zhvillon punimet më 7 shkurt. Gjatë këtij kongresi do të mbahen zgjedhjet për president të UEFA-s si dhe për tetë anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s.

Presidenti aktual, Aleksandër Çeferin, pritet të rizgjidhet për mandat të ri katërvjeçar në krye të organizatës së futbollit evropiane, duke pasur parasysh se nuk ka kundërkandidat, derisa garë e madhe pritet për anëtarët e Komitetit Ekzekutiv, ku kandidat është edhe presidenti i FShF-së, Armand Duka.

Sadiku: Te Lugano për t'u rikthyer në formë

TIRANË, 5 SHKURT - Armando Sadiku është gati për rikthimin në fushë. Tashmë pjesë e Luganos, sulmuesi i kombëtares shqiptare do të jetë i huazuar te ekipi nga Zvicra deri në fund të sezonit. Rikthimi i tij e ka vendosur atë në qendër të vëmendjes. Në një prononcim për "Blick.ch", Sadiku thekson se te Lugano ndihet si në shtëpi. "Është si shtëpi për mua. Kjo e bën çdo gjë të lehtë. Erdha këtu për t'u rikthyer në nivelin tim dhe më pas të vazhdoj në Spanjë. Jam shumë mirë tani. Ka qenë periudhë rehabilitimi për 5 muaj e gjysmë. Do të më duhen edhe 2 ose 3 javë që të jem plotësisht gati. Mund të luaj disa minuta ndaj Thunit", ka thënë Sadiku.

Prishtina beson në kualifikim

PRISHTINË, 5 SHKURT - Z Mobile Prishtina do ta luajë sonte (e mërkurë) ndeshjen e fundit në kuadër të FIBA Europe Cup. Në rast se skuadra e Prishtinës e mposhtë skuadrën e Pinar Karsiyakan, atëherë do ta kalojë grupin. Pavarësisht se në ndeshjen e parë Prishtina kishte pësuar humbje me rezultat 107-85, trajneri Damir Mulaomeroviq është optimist se do të arrihet fitorja. "Ftojmë të gjithë tifozët që t'i përkrahin këta djem të mrekullueshëm, këtë qytet dhe këtë klub që po bën histori", ka thënë ai. Ndërsa basketbollisti më i mirë i prishtinasve, Dardan Berisha, ka thënë: "Kjo është një ndër ndeshjet më të rëndësishme jo vetëm të klubit Prishtina, por edhe basketbollit të Kosovës në përgjithësi. Do ta japim maksimumin dhe me lojtarin e gjashtë të Klubit 'Plisat' besojmë në fitore", ka thënë Berisha. Për fitore optimist është edhe kapiteni Edmond Azemi. Ndeshja në mes të Z Mobile Prishtina dhe Pinar Karsiyakan fillon nga ora 19:00.

Hardeni shkëlqen në fitoren e Houstonit

REZULTATET

Detroit - Denver	129-103
Washington - Atlanta	129-137
Brooklyn - Milwaukee	94-113
New Orleans - Indiana	107-109
Phoenix - Houston	110-118
Sacramento - San Antonio	127-112

ARIZONA, 5 SHKURT - James Hardeni vazhdon të bëjë një paraqitje të shkëlqyer në NBA, duke realizuar 44 pikë në fitoren që Houstoni e arriti në fushën e Phoenixit, me rezultatin 118-110. Kjo është sfida e 27 radhazi për basketbollistin teksan që realizon mbi 30 pikë, duke konfirmuar se është pretendenti kryesor edhe këtë sezon për ta fituar titullin MVP. Ndeshja u dominua nga Houstoni, që pati gjatë gjithë kohës një avantazh të lehtë, ndërsa për vendësit nuk mjaftuan 25 pikët e Jacksonit dhe 23 të Oubres. Denveri humbet 129-103 në fushën e Detroitit dhe humbet disi terren karshi Golden States në garën për kreun në Perëndim. Fitore e lehtë e skuadrës vendëse, ku u dallua Drummond, autor i 27 pikëve e 12 reboundeve, ndërsa për miqtë u dallua Lyles me 20 pikë, raporton "Telesport". Humbet edhe skuadra e San Antonios, që u mund 127-112 nga Sacramento, sfidë ku vendësit patën një epërsi të lehtë gjatë gjithë kohës dhe në minutat e fundit thelluan epërsinë e fituan me meritë. Bagley realizoi 24 pikë e 12 rebounde, duke i bërë të pavlefshme 24 pikët e DeRozanit. Fiton skuadra e Atlantas, që mundi 137-129 Washingtonin në shtëpinë e kësaj të fundit, ndeshje spektakolare dhe me emocione, me 9 lojtarë të Atlantas që realizuan mbi 10 pikë. Për Washingtonin u dallua Beal me 27 pikë e Ariza me 25, por ishin të vetmuar dhe të pambështetur nga pjesa tjetër e ekipit. Milwaukee vijon ta kryesojë renditjen në Lindje pas fitores 113-94 ndaj Brooklynit, ku vazhdon të shkëlqejë greku Antetokounmpo, autor i 30 pikëve e 15 reboundeve. Në sekondat e fundit fiton Indiana, 109-107 ndaj New Orleansit, sfidë ku vendimtar ishte Collisoni me 22 pikë.

SHKURT

Behrami: Pres t'u kthehemi fitoreve

Kapiteni i Udineses, Valon Behrami, pret që skuadra e tij t'i kthehet fitores në Serinë A, pasi këtë vit ende nuk e ka shijuar asnjë. "E kemi merituar fitoren me Fiorentinën, pasi ishim shumë më të mirë dhe në këtë ndeshje i humbëm dy pikë. Pres t'u kthehemi fitoreve, pasi po kalojmë nëpër një periudhë të vështirë. Ka kohë që nuk kemi fituar, por pres t'i gëzojmë tifozët tanë", ka thënë Behrami.

Gjykata e dënon Mourinhon me një vjet burg

Trajneri Jose Mourinho është dënuar me 12 muaj burg dhe gjobë për shkak të mosdeklarimit të të ardhurave që vinin nga e drejta e imazhit në kohën kur ai ishte trajner i Real Madridit. Për shkak se dënimi është më i ulët se dy vjet, "Special One" thotë se i shpëton qelisë teksa do të duhet të paguajë 2.2 milionë euro gjobë. Nuk është hera e parë që një personazh nga bota e sportit dënohet për evazion fiskal, pasi kujtojmë që disa kohë më parë Cristiano Ronaldo u gjobit me 19 milionë euro dhe 23 muaj burg. Ylli i Juventusit arriti t'i shpëtonte burgut për vetëm një muaj.

Shoku i Salas: Futbollisti u detyrua të hipte në atë avion

Zhdukja e sulmuesit Emiliano Sala tronditi një pjesë të madhe të opinionit. Pas rreth dy javësh kërkimesh, një mbetje e avionit me të cilin futbollisti po udhëtonte u gjet në fund të Kanalit të La Manshit, teksa një trup shihet në imazhet e kapura nga një mjet nënujor në rrënojat e avionit, por nuk është identifikuar ende se për kë bëhet fjalë. Ndërkohë që shpresat për jetën e Salas janë shuar, një mik i tij nëpërmjet një deklarate të dhënë për mediet tregon se, sipas tij, gjithë kjo histori ka një keqbërës se Emiliano është detyruar të hipte në atë avion. "Ekziston një e vërtetë e madhe pas gjithë kësaj dhe kjo është se ka një keqbërës. Sepse Emiliano kurrë nuk vendosi të fluturojë me atë aeroplan. Këto janë të gjitha detyrime që dikush i pranon si një lojtar profesionist. Emiliano u detyrua të hipte në atë avion", u shpreh Maksimiliano Duarte.

Parejo rinovon kontratën me Valencian deri më 2022

Mesfushori Dani Parejo firmosi rinovimin e kontratës me Valencian deri në verën e vitit 2022. Lajmi u konfirmua nga vetë klubi spanjoll, ku theksohet fakti që në kontratën e kapitenit është futur edhe një klauzolë për largimin e tij, e cila kap shifrën e 50 milionë eurove. Dani Parejo është një nga lojtarët kyç të repartit të mesfushës së skuadrës që drejtohet nga Marcelino. 29-vjecari u bashkua me Valencian në vitin 2011 për 6 milionë euro, pasi la skuadrën e Getafes. Parejo numëron më shumë se 300 paraqitje me fanellën e galicianëve, ndërsa në nisje të karrierës mesfushori ka luajtur edhe për Real Madridin.

Marquezi rikthehet me teste pas operacionit

Marc Marquez ka nisur përgatitjet për Botërorin e ri të MotoGP-së, që do të nisë pas disa javësh. Piloti spanjoll, që iu nënshtrua një ndërhyrjeje kirurgjikale në shpatull në dhjetor të vitit 2018, zbriti në pistën e Sepangut për t'i zhvilluar përgatitjet në prag të testeve parasezonale për sezonin e ri. Marquez u operua në Spitalin Universitar "Dexeus" të Barcelonës, e më pas së bashku me stafin e përpiluan planin për ta forcuar shpatullën e pilotit, që ai të ishte gati për testet parasezonale që do të zhvillohen këtë fundjavë. "Kisha nevojë për këtë, preka tokën me bërryl. Bëmë disa xhiro që më ndihmuan të kuptoja sesi është situata. Problematike rezultoi forca e ushtruar në frenim, sidomos në krahun e majtë, që lidhet edhe me shpatullën e kësaj ane. Kjo është pika ku duhet ta vazhdojmë punën", ka thënë Marquezi.

Autor: GAZMEND MORINA

KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.) — AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ..... EVANS — LIDHJA / SHENJA QË PËRFAQËSON NJË TINGULL MUZIKOR — SHPIRTI (Lat.) — LLOJ BUKE

BANOR I NJË QYTETI TONË — LLOJ BIME QË PËRDORET SI ERËZ PËR GJELLË (shq.) — INATOSJE — DY BASHKË-TINGËLLORE — PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE / ISHULL NË SHQIPËRI — GOTË PREJ BAKRI — KALË SHALE / QENIE MBINJERËZOR E ME FUQI TË FSHEHTË (mit.)

ZANORE — AFËRDITA / DRESHAJ / ALUMIN — ZANORE / PËRSHËNDE-TJE ALLATURKA

OJNAT — KOPE, TUFË (sh.shq.) / PRONË E VOGËL E SPAHINJVE FEUDAL OTOMANE

EPOKA E RE — VARFËRI — KRYEQYTETI I NJËRIT NDËR SHTETET ME FUQINË MË TË MADHE EKONOMIKE NË BOTË — NJERI I PAGDHENDUR E I TRASHË; / MALATAK TONELATË — UGURUAI, NORVEGJIA — GJËMË, E KEQE E MADHE QË I BËHET DIKUJT / BASHKËT.

SHTATORJA — RASA E PARË E LAKIMIT; EMËRORE / TËRËSIA E ANIJEVE LUFTARAKE

SKLLAV I LIRUAR A FSHATAR I LIRË — DY BASHKË-TINGËLLORE / SHKENCA MBI BIMËT — NUK NXJERR ZË A FJALË NGA HABIA A NGA FRIKA / MARR NJË SY GJUMË — PATRIOTI SEFERI (shq.)

KËNGËTARI I NJOHUR AMERIKAN — GAZETË E MADHE NË GJERMANI / DREJTIM — QË IA PRET MENDJA; I SHKATHËT — ZANORE / LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE

SHOK — NGJYRË (huaj) / BASHKËT. — ARCITECTURE RESEARCH OFFICE / BASHKËT. — INSTITUCION — DY BASHKË-TINGËLLORE / ZAMBIA, ESTONIA

FJALË MOHUESE — BRINJËT QË FORMOJNË KËNDIN E DREJTË TË TREKËND-ËSHIT / VONESA — NDARJE E MADHE ADM-INISTRATIVE NË PERANDORINË OSMANE — EMËR YNI / MASHKULLI / PORTIERI KASILLAS

ZANORE — BASHKËT. / PJESË E MEKANIKËS QË STUDION LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE — DIÇKA QË NUK ËSHTË FITUAR ME PUNË TË NDERSHME / AKTORJA THORNTON (shqip.) — VENEZIA, IVREA / FUTBOLLISTI GJERMAN BOROWSKI — RRJETA E TENISIT / QË I PËRKET NJË KOHE TË LASHTË

EPOKA E RE — PIKË; NJOLLË E RRUMBULL-AKËT (ang.) / EMËR MASH. MYSLIMAN — NATRIUM / GOJËDHËNA — QËNDRUE-SHMËRI (arab.) / CAKTIM I DIKUJT NË NJË DETYRË — INDIA, ZAIRI / RAFINERIA E ZAGREBIT

AGJËRIMI (krah.) — HIDROKA-RBUR I PANGOPUR / PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA — DY (turq.) / KUZHINË POPULLORE PRANË XHAMISË

NJËSIM, BASHKIM — LLOJ PUSHKE E GJATË, E NGJASHME ME HUTËN / FUQI, FORCË — TOKA E BËRË GATI PËR TË MBJELLË

BAKËRPUN-UES (sh.shq.) — BASHKËT. / AKTORI STILLER (shq.) — KULAÇE (shq.) / ISH "MISS ALBANIA" HYGERTA

KËNGËTARJA ADELINA — NJË FIGURË E BALETIT KLASIK / SUELA (perkdh.) — FILLIM I AGIMIT / AKTORJA ANGLEZE ... FRIEL

KAM NJOHURI PËR DIÇKA — IPSVICH / SALI VESELI — PUSULLA / AGIM TEJECI — RAMADAN AVDIU / BASHKËT. — ZANORE / KYÇ

NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË — GJERMAN I VJETËR / ZANORE — KRYELARTË / BASHKËT.

ANIJATË (sh.shq.) — AKTORI YNË FLLOKO — TASH

SUDOKU

			3			6	7	8
		7						4
	2		4					
7					5		6	
		4	7			9		
	3	1	2					5
					6		3	
6						2		
1		5			2			

